



Thirrjet e hapura në **Digital Europe Programme** **(DIGITAL)**

Thirrje të hapura në kuadër të **Programi i Europës Digjitale**

“Digital Europe Programme” ka hapur disa thirrje për aplikim ku Shqipëria mund të aplikojë me projekte konkurruese si nga sektori publik, privat dhe akademia për një numër thirrjesh në fushën e digjitalizimit të shoqërisë dhe ekonomisë.

Digital Europe Programme përmban pesë objektiva specifike:

Objektivi 1: Përpunimi kompjuterik me performancë të lartë;

Objektivi 2: Inteligjenca artificiale, të dhënat dhe cloud;

Objektivi 3: Siguria kibernetike dhe besimi;

Objektivi 4: Aftësitë digjitale të avancuara;

Objektivi 5: Përhshajtimi i përdorimit sa më të mirë të teknologjive

Programi ka hyrë në fazën e publikimit të thirrjeve specifike në një listë prej 5 projektsh ku të gjithë të interesuarit mund të gjejnë detajet, afatet, rezultatet e pritshme, objektivat dhe kriteret e tjera të procedurave.

Lista e thirrjeve është si në vijim:

-DIGITAL-2026-AI-09-GENAI-PA

-DIGITAL-2026-AI-09-VIRTUAL-TESTBEDS-STEP - Virtual worlds test beds

-DIGITAL-2026-EDIH-EU-EEA-09-CONSOLIDATION-STEP

-DIGITAL-2026-SUPPORT-09-NCP-NETWORK

-Second Call for Innovation Studies – Generative AI Models (FFplus)

THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

Apply AI: GenAI for the public administrations, DIGITAL-2026-AI-09-GENAI-PA

Afati i fundit i aplikimit: 3 mars 2026, ora 17:00:00

Kush mund të aplikojë:

Institucionet e arsimit të lartë, organizatat kërkimore dhe të teknologjisë, organizatat e shoqërisë civile, organizatat joqeveritare.

Objektivi kësaj thirrje është:

Qëllimi i këtij veprimi është të koordinojë dhe mbështesë projektet pilot që zhvillojnë zgjidhje të Inteligjencës Artificiale Gjenerative (GenAI) të integruara plotësisht në flukset operacionale dhe sistemet IT të administratave publike pjesëmarrëse.

Ky veprim ka dy qëllime kryesore:

1. Rritjen e shkallëzueshmërisë dhe replikimit të zgjidhjeve të suksesshme të pilotëve GenAI, duke përfshirë aftësinë e tyre për t'u zbatuar nga administrata të tjera publike dhe për t'u përshtatur me një numër në rritje përdoruesish ose fushash aplikimi.
2. Identifikimin e nevojave të përbashkëta të administratave publike për zgjidhje GenAI "Made in Europe", duke lehtësuar bashkimin e kërkesës në nivel BE-je për startup-e evropiane.

Si rezultat i këtyre përpjekjeve, veprimi do të thellojë bashkëpunimin ndërmjet administratave publike në të gjitha Shtetet Anëtare, duke vendosur themelet e një komuniteti të qëndrueshëm GenAI. Përmes shkëmbimit të njohurive, mjeteve dhe përvojave të ndërsjella, ky komunitet do të ndihmojë në përsheptimin e adoptimit dhe forcimin e besimit në zgjidhjet evropiane të AI-së.

Përbërja e konsorciumit: Të paktën 3 aplikantë të pavarur nga 3 vende të ndryshme

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



Buxheti: EUR 1 800 000

**Forma e financimit: Veprim për Koordinim dhe Mbështetje
(Coordination and Support Actions – CSA) – 100% financim**

THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

DIGITAL-2026-AI-09-VIRTUAL-TESTBEDS-STEP

Virtual worlds test beds

Afati i fundit i aplikimit: 3 mars 2026, ora 17:00:00

Kush mund të aplikojë:

Propozimet duhet të përfshijnë partnerë me përvojë të dëshmuar në zbatimin e fushave të përmendura më sipër dhe të sigurojnë një përfaqësim të gjerë të aktorëve që lidhen me botët virtuale. Partnerët duhet të mbulojnë në mënyrë të besueshme sektorët e synuar nga propozimi dhe të tregojnë aftësi për të arritur dhe përfshirë në mënyrë efektive aktorët përkatës sektorialë në të gjithë Evropën (p.sh. ofruesit e teknologjisë, përdoruesit, institucionet qeveritare, komunitetin financiar dhe atë lokal).

Objektivi kësaj thirrje:

Për këtë veprim parashikohet mbështetja e dy qendrave testuese sektoriale me standard botëror përmes dy projekteve:

- një për aplikime industriale (si prodhimi, ndërtimi ose dizajni industrial);
- dhe një për aplikime shoqërore (si arsimi dhe trajnimi, trashëgimia kulturore dhe përvoja të tjera kulturore, administrata publike ose kujdesi shëndetësor).

Çdo qendër testuese duhet të krijojë një rrjet strukturash me masë kritike në të paktën tre Shtete Anëtare të BE-së ose vende të asociuara.

Qendrat testuese do të ofrojnë të gjithë ekspertizën dhe infrastrukturën e nevojshme për hartimin dhe zbatimin e metodologjive të testimit, duke kombinuar strukturat e botës fizike me ato të botëve virtuale.

Kjo ndërthurje e strukturave fizike dhe virtuale do të përdoret nga ofruesit e teknologjisë dhe aktorët kryesorë në mjedise dhe kushte reale.

Në varësi të sektorëve të përzgjedhur, këto mund të përfshijnë, për shembull, objekte prodhimi, spitale ose kantierë ndërtimi.

Përbërja e konsorciumit:

Minimum 4 aplikantë të pavarur nga 3 vende të ndryshme të pranueshme, nga të cilët:

- të paktën 1 organizatë kërkimore (p.sh. universitet, institut kërkimor ose RTO),
- të paktën 1 kompani private për secilin sektor të identifikuar si i synuar në propozim.

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



Buxheti: EUR 17 000 000

Forma e financimit: 50% grant

THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

Consolidation of the Network of European Digital Innovation Hubs (EDIHs with reinforced AI focus)

DIGITAL-2026-EDIH-EU-EEA-09-CONSOLIDATION-STEP

Afati i fundit i aplikimit: 3 mars 2026, ora 17:00:00

Kush mund të aplikojë:

Propozimet duhet të dorëzohen nga kandidatët për Qendra Evropiane të Inovacionit Dixhital (EDIH), të cilat vijnë nga EDIH-të ekzistuese të financuara nga Programi "Europa Digjitale", si edhe nga EDIH-të që kanë marrë "Seal of Excellence"

Objektivi kësaj thirrje:

Qëllimi i kësaj thirrjeje është konsolidimi i rrjetit të Qendrave Evropiane të Inovacionit Dixhital (EDIHs), me synimin për të mbuluar të gjitha rajonet e Bashkimit Evropian dhe vendet e asociuara, duke forcuar performancën dhe kapacitetin e tyre për të përmbushur nevojat dixhitalizuese lokale, rajonale, kombëtare dhe evropiane.

Me përvojë dhe kapacitete të shtuara, EDIH-të do të vazhdojnë të ofrojnë setin e plotë të shërbimeve që karakterizojnë një qendër EDIH, përfshirë infrastrukturën e nevojshme, duke u fokusuar kryesisht në zona të caktuara gjeografike dhe duke adresuar nevojat për transformim dixhital të NVM-ve, ndërmarrjeve të mesme (mid-caps) dhe/ose organizatave të sektorit publik në nivel lokal.

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



Buxheti: EUR 79 200 000

Forma e financimit: 50% grant

THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

Supporting the Network of National Contact Points (NCPs) of the Digital Europe Programme, DIGITAL-2026-SUPPORT-09-NCP-NETWORK

Afati i fundit i aplikimit: 3 mars 2026, ora 17:00:00

Kush mund të aplikojë:

Propozimet duhet të dorëzohen nga:

- të paktën një aplikant i pavarur, i themeluar në një Shtet Anëtar, dhe
- të paktën dy aplikantë të tjerë të pavarur, secili i themeluar në Shtete Anëtare ose në Vende të Asociuara të ndryshme.

Objektivi kësaj thirrje:

Të mbështetet koordinimi dhe forcimi i kapaciteteve të Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCPs) për Programin "Europa Digjitale", si dhe përgatitja dhe zbatimi i veprimeve që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për mundësitë e financimit që mund të nxisin zbatimin e politikave digjitale të BE-së, rritjen e dukshmërisë dhe ndikimit të programit, si dhe shpërndarjen dhe shfrytëzimin afatgjatë të rezultateve.

Ky veprim duhet të forcojë kapacitetin e të gjitha NCP-ve për të përmbushur mandatin e tyre, të rrisë mësimin përmes kolegëve dhe ndarjen e njohurive, si dhe të nxisë zhvillimin e një komuniteti interaktiv dhe koheziv të praktikës.

Përbërja e konsorciumit:

Propozimet duhet të dorëzohen nga:

- Të paktën një aplikant i pavarur, i themeluar në një Shtet Anëtar, dhe
- Të paktën dy aplikantë të tjerë të pavarur, secili i themeluar në Shtete Anëtare ose Vende të Asociuara të ndryshme.

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



Buxheti: EUR 1 800 000

Forma e financimit: 100% grant

THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

Second Call for Innovation Studies Generative AI Models (FFplus)

Afati i fundit i aplikimit: 25 shkurt 2026, ora 17:00:00

Objektivi kësaj thirrje:

Të mbështeten SMEs dhe Start-up-et evropiane për zhvillimin e modeleve gjenerative të inteligjencës artificiale (p.sh. LLMs, foundation models) duke përdorur burime të mëdha kompjuterike (HPC). Qëllimi është fuqizimi i bizneseve të vogla me aftësi inovative, duke rritur konkurrueshmërinë e tyre në treg dhe duke siguruar zhvillimin e teknologjive të reja për aplikime komerciale dhe shoqërore.

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



Buxheti: EUR 4 000 000

Forma e financimit: 100% mbulim i kostove direkte të pranueshme

